

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"GLOBUS AGENCY " SHPK**

Sot më datë 20.02.2023, une i nenshkruari:

1. Xhonatan MEHMETI, lindur ne Durres, i datëlindjes 15.09.1996, madhor e me zotesi te plete per te vepruar, me numër identifikimi J609150791
Kam përpiluar këtë Akt Themelimi të Shoqërisë tregtare "GLOBUS AGENCY " SHPK me termat e mëposhtme:

NENI 1

Emri dhe forma ligjore

Shoqëria "GLOBUS AGENCY " SHPK, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, Ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Selia e Shoqerise

Selia e shoqerise eshte

Durres, Lagjja 1, Rruga Xhamia, Pallati 1053, Kat. I-re.

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithe territorin e Shqiperise si dhe jashtë saj, në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

NENI 3

Objekti i veprimtarise

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Aktivitet ne fushen e sherbimeve, agjenci detare dhe te rekomandimeve detare, broker detar, ajror dhe siguracionesh, sherbime detare dhe ajrore, sherbime te transportit dhe

te ngashme me te, sherbime spedicioni per ngarkesa te vogla dhe mjete transporti vendase brenda dhe jashte Shqiperise, sherbime per aktivitet depozitimi dhe magazinimi i mallrave dhe i mjeteve ne magazinat ose depot nationale ose te tjera, perqatitjen e praktikave doganore ne per gjithesi per llogari te te treteve, aktivitet ne veprimet portuale, asistence dhe organizim i operacioneve te ngarkim - shkarkimit te mallrave, sherbime qe lidhen me aktivitet te komisarit te avarive dhe likuidatorit te avarive, organizimi i shkarkimit dhe levizjes se konteniereve. Shoqeri spedicionere, shërbime spedicionere, transport mallrash të ndryshme brenda dhe jashtë vendit per te trete dhe me qira. Dhenie dhe marrje mjetet me qira, asete, pasuri te paluajtshme etj. Agjenci turistike, Tregtim, importi-eksport i mallrave te ndryshme industriale ne per gjithesi. Shoqeria ka te drejte te bashkepunoje me qellim fitimi ne ndermarrje ose Shoqeri te tjera te cfaredo lloji, tipi dhe sido qe te jene krijuar ato. Cdo lloj tjeter aktiviteti financiar, tregtar, industrial, ndertimi qe do te shihet ne interes te realizimit te objektit social te Shoqerise. Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti tjeter te ligjshem.

NENI 4

Kohëzgjatja e shoqerise

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 5

Kapitali i Shoqerise

Kapitali i shoqërisë është 100.000(njeqindmije) lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Xhonatan MEHMETI zoteron i 1 kuote, me vlerë 100.000 lekë, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë.

NENI 6

Organet drejtuese të Shoqërisë

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjeçar, me te drejte riemerimi. Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. Xhonatan MEHMETI te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqësimit e shoqerise.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto te drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 7

Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijoje çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqërítë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ortaku Themelues

Xhonatan MEHMETI
Xhonatan Mehmeti

